

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE

LËNDA: FILOZOFI DHE SOCIOLOGJI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

1. Për 20 pyetjet me zgjedhje (alternativa), pasi të keni qarkuar alternativën e saktë në test, duhet të mbushni rrathët përkatës të tabelës në fletëpërgjigje.

Lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna në fletëpërgjigje.

2. Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet duhet të shkruhen brenda zonës së kufizuar me vijë. Çdo përgjigje e shkruar jashtë vijave kufizuese, nuk do të vlerësohet.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	2	4	6	7	10	14	15	16	26	28	30	31
Pikët												
Kërkesa	32	34	35									
Pikët												

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

Sociologji

1. Tabutë në sociologji përcaktohen si: **1 pikë**
- A) norma ndaluese.
B) kulturë materiale.
C) norma udhëzuese.
D) norma urdhëruese.
2. Shpjegoni konceptet e mëposhtme, duke dhënë nga një shembull për secilin qëndrim: **4 pikë**
- a) etnocentrizëm _____
Shembull _____

- b) ksenocentrizëm _____
Shembull _____

3. Vetja shoqërore, sipas Mead: **1 pikë**
- A) është e pranishme që në lindje.
B) është e njëjtë me trupin biologjik.
C) krijohet pavarësisht nga të tjerët.
D) zhvillohet nga përvoja shoqërore.
4. Shpjegoni ndikimin që kanë në procesin e shoqërizimit dy faktorët e mëposhtëm: **2 pikë**
- a) familja _____

- b) shkolla _____

5. Shkeljet e ligjeve nga nëpunësit e lartë, për të siguruar përfitime të pamërituara, quhen krime: **1 pikë**
- A) të mërisë.
B) pa viktime.
C) nga pakujdesia.
D) të jakave të bardha.
6. Sjelljet deviante janë të pranishme në të gjitha shoqëritë, por kuptimi i tyre ndryshon shumë nga njëra shoqëri në tjetrën. Identifikoni dy faktorë që ndikojnë në karakterin relativ të deviancës: **2 pikë**
1. _____
2. _____

7. Me gjithë përpjekjet e kuadrit ligjor për përmirësimin e barazisë gjinore, në realitet shfaqen forma të pabarazisë. Shpjegoni si shfaqet pabarazia gjinore: **2 pikë**

a) në punësim dhe të ardhura _____

b) në familje _____

8. Martesa monogame quhet bashkimi i: **1 pikë**

- A) një burri dhe një gruaje njëkohësisht.
- B) një burri me shumë gra njëkohësisht.
- C) një gruaje me shumë burra njëkohësisht.
- D) martesës dhe rimartësive të njëpasnjëshme.

9. Çfarë kuptojmë me gjenocid: **1 pikë**

- A) vetëveçim i grupeve etnike.
- B) asimilim i grupeve etnike.
- C) shfarosje e grupeve etnike.
- D) përshtatje e grupeve etnike.

10. Dalloni dy funksionet e mëposhtme të fesë, duke dhënë nga një shembull për secilin faktor: **4 pikë**

a) Faktor uniteti shoqëror _____

Shembull _____

b) Burim mosmarrëveshesh _____

Shembull _____

11. Rritja e përqendrimit të njerëzve në zona gjeografike të kufizuara, të quajtura qytete, lidhet me procesin e:

1 pikë

- A) urbanizimit.
- B) eksurbanizimit.
- C) bashkësisë rurale.
- D) ekologjisë urbane.

12. Procesi i ndarjes së shtetit dhe i mjaft institucioneve të tjera të shoqërisë, veçanërisht të shkollës nga feja lidhet me: **1 pikë**

- A) ateizmin.
- B) laicizmin.
- C) politeizmin.
- D) eklesinë.

13. Lëvizjet që synojnë të realizojnë ndryshime shoqërore të kufizuara në shoqëri të caktuara, quhen lëvizje:

1 pikë

- A) realizuese.
- B) alternative.
- C) reformuese.
- D) revolucionare.

14. Përcaktoni dy veçori të shtresimit shoqëror:

2 pikë

1. _____
2. _____

15. Shoqëritë e ditëve të sotme karakterizohen nga një shkallë e lartë e përzjerjes së popullsisë me përkatësi etnike e racore të ndryshme. Shpjegoni dy aspekte të pluralizmit, si formë e marrëdhënieve ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne.

2 pikë

1. _____

2. _____

16. Përshkruani dy mundësi që shoqëria moderne i ofron individëve për zgjedhje vetjake:

2 pikë

1. _____

2. _____

17. Vëzhgimi që shtrihet në të gjitha dukuritë ose veprimtarinë e objektit që studiohet, quhet:

1 pikë

- A) periodik.
- B) i pjesshëm.
- C) jo sistematik.
- D) i përgjithshëm

18. Metoda e studimit sociologjik, që siguron shpejtësinë e mbledhjes së opinionëve të një numri shumë të madh njerëzish, është:

1 pikë

- A) anketa.
- B) vëzhgimi.
- C) intervista.
- D) eksperimenti.

Filozofi

19. Lindja e filozofisë u nxit nga: 1 pikë
- A) kureshtja e njerëzve.
 - B) kërkimi i së vërtetës.
 - C) frika ndaj të panjohurës.
 - D) të gjitha së bashku.
20. Platoni, në krye të qeverisjes së qytetit të tij ideal vendosi: 1 pikë
- A) popullin.
 - B) aristokracinë.
 - C) mbretin filozof.
 - D) monarkun absolut.
21. Sipas Aristotelit, motori i parë, që vë në lëvizje gjithçka, është: 1 pikë
- A) material.
 - B) i fundëm.
 - C) i kufizuar.
 - D) i përjetshëm.
22. Skepticizmi në lashtësi shtronte nevojën e: 1 pikë
- A) besimit tek njohja njerëzore.
 - B) besimit tek vërtetësia e dijes.
 - C) dyshimit mbi të vërtetën absolute.
 - D) optimizmit mbi gjykimet e njëanshme.
23. Stoikët mendojnë se njeri i mençur është ai që, në jetë: 1 pikë
- A) nuk e di rolin e tij.
 - B) e di rolin që i takon.
 - C) nuk e luan rolin e tij.
 - D) nuk mendon për rolin e tij.
24. Filozofia e Senekës ishte në shërbim të: 1 pikë
- A) fesë.
 - B) zotave.
 - C) natyrës.
 - D) politikës.

25. Sipas Shën Akuinit, një nga provat përmes të cilës vërtetohet ekzistenca e Zotit, lidhet me: **1 pikë**

- A) dukuritë kaotike shoqërore.
- B) rendin e ngjarjeve historike.
- C) rregullsinë perfekte në natyrë.
- D) mungesën e ligjeve harmonike.

26. Përcaktoni nga dy tipare të periudhës së Mesjetës dhe të Rilindjes në Europë: **4 pikë**

Mesjeta:

1. _____

2. _____

Rilindja:

1. _____

2. _____

27. Qyteti utopik i diellit i Kampanelës, do të drejtohej nga: **1 pikë**

- A) Papa.
- B) monarku.
- C) perandori.
- D) parlamenti.

28. Përshkruani dy momente të dualizmit në filozofinë e Dekartit: **2 pikë**

1. _____

2. _____

29. Thënia se: "Gjithçka që ekziston është te Zoti dhe asgjë nuk mund të ekzistojë apo të konceptohet pa Zotin, Zoti është shkaku i të gjitha gjërave", i takon filozofit të mëposhtëm: **1 pikë**

- A) Hobs
- B) Hjum
- C) Dekarti
- D) Spinoza

30. Idetë liberale të Xhon Lokut kanë ndikuar në fushën politike. Listoni dy karakteristika të shtetit liberal, sipas modelit të Lokut: **2 pikë**

1. _____

2. _____

31. Rendisni tre tipare të Iluminizmit European të shekullit të XVIII- të: **3 pikë**

1. _____
2. _____
3. _____

32. Identifikoni tri karakteristika të periudhës kur lindi filozofia moderne e shekullit të XIX-XX: **3 pikë**

1. _____
2. _____
3. _____

33. Koncepti themelor për njohjen te filozofia e Xhon Djujt është: **1 pikë**

- A) intuita.
- B) arsyeja.
- C) dyshimi.
- D) përvoja.

34. Niçe shprehej se: "Nuk ekzistojnë fenomene morale, ekzistojnë vetëm interpretime morale të fenomeneve." Përshkruani tri karakteristika të qëndrimit që mban Niçja ndaj vlerave të moralit: **3 pikë**

1. _____

2. _____

3. _____

35. Analizoni thënien e Marksit se: "Ndryshe mendohet në pallat dhe ndryshe në kasolle", duke theksuar tre momente të materializmit të tij: **3 pikë**

1. _____
2. _____
3. _____